

URDHËR
Nr. 208, datë 12.4.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 100, DATË 10.2.2021,
“PËR KUFIZIMIN E AKTIVITETEVE TË BAREVE, RESTORANTEVE, *FAST*
***FOOD* DHE LOKALEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 7, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik , si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 809/8, datë 11.4.2021, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 100, datë 10.2.2021, “Për kufizimin e aktivitetëve të bareve, restoranteve, *fast food* dhe lokaleve”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Pika 1 e urdhrit riformulohet si më poshtë vijon:

“1. Kufizimin e aktivitetit të bareve, restoranteve, *fast food* dhe lokaleve, që ofrojnë shërbim për klientët, nga ora 22:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, nga data 12.4.2021 deri në një urdhër të dytë.”.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu